

PËRFITIMET NGA BOTIMI ELEKTRONIK I DOKUMENTAVE ZYRTARE

Dr. Rovenah Bahiti¹, Dr. Petrit Dollani²

"Nuk është më e forta, as më inteligjentja specia që mbijeton; është ajo që i përshtatet më me lehtësi ndryshimeve."

Charles Robert Darwin (1809-1882)

Hyrje

Qeveritë e vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, ashtu si dhe industritë e prodhimit dhe shërbimit, po u nënshtrohen gjithnjë e më tepër transformimeve në *"ekonominë e re"*. Qeveritë po distancohen nga organizimet burokratike duke u bërë më fleksibël në lidhje me nevojat e qytetarëve. Në të njëjtën kohë, qeveritë po përpiqen që të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e tyre të brendshëm lidhur me kostot dhe cilësinë e qeverisjes.

Teknologjia e Informacionit (TI) po luan rol kyç në mundësimin e këtij modernizimi të qeverisjes. Ajo i jep mundësi si qytetarëve ashtu edhe kompanive të bashkëveprojnë (madje edhe të drejtojnë biznese) me qeverinë, shtatë ditë në javë dhe 24 orë në ditë, duke përdorur mjete të ndryshme komunikimi si kompjuter, telefon, kabina vetë-shërbimi, ATMs (Automated Teller Machine) si dhe njësitë *"one-stop shops"*. TI ofron gjithashtu mundësi të pafundme për të përmirësuar funksionet e brendshme operationale dhe mbështetëse brënda sferës së qeverisjes.

Kërkesat për të lëvizur drejt e-Qeverisjes janë të mjaft mëdha dhe është kërkesë e kohës shfrytëzimi i teknologjive të reja me qëllim të rritjes së efikasitetit në punën e institucioneve qeveritare dhe në ofrimin e shërbimeve më të mira.

Qeverisja elektronike ose ndryshe e-Qeverisja është përdorimi i mjeteve dhe sistemeve që mundësohen nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) për të siguruar shërbime më të mira publike për qytetarët dhe bizneset.

^{1 2} Fakulteti i Ekonomisë, UT

Qëllimi i këtij referimi është identifikimi dhe shqyrtimi i disa prej përfitimeve kryesore që vijnë prej zbatimit në praktikë të e-qeverisjes në përgjithësi, të botimit elektronik të dokumentave zyrtare në veçanti, si dhe konkretizimi bazuar në disa të dhëna e fakte konkrete që lidhen me vendin tonë, krahasuar me praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara si dhe atyre në zhvillim.

1. Përfitimet dhe problemet që lidhen me e-qeverisjen

Zhvillimi i shoqërisë së informacionit është thelbësor jo vetëm për zhvillimin e shpejtë të Shqipërisë por edhe të rajonit. Duke iu bashkangjitur nismës rajonale të e-SEE në qershor 2002, Shqipëria shprehu gadishmërinë dhe angazhimin e saj për integrim dhe bashkëpunim, si dhe tregoi interesin e saj në ndjekjen e politikave për zhvillim me anën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Por zhvillimi i shoqërisë së informacionit dhe zbatimi i qeverisjes elektronike është një proces i gjatë dhe duhet punuar shumë për të arritur qëllimet dhe për të përmbushur ambiciet drejt integritimit në BE.

1.1. Cilat janë përfitimet e e-qeverisjes për administratën publike dhe shoqërinë në përgjithësi ?

- ***E-qeverisja përmirëson eficientë***

Një e-qeverisje efektive përfshin një mënyrë të re organizimi, veprimi si dhe sjellje në mënyrë që shërbimet publike të shpërndahen në mënyrë më eficiente drejt njerëzve që kanë nevojë për t'i përdorur. Implementimi me sukses i e-qeverisjes bën të mundur që qytetarët, bizneset dhe organizatat të kryejnë punët që lidhen me qeverinë më lehtë, më shpejtë dhe me kosto më të ulët.

TIK mundësojnë përmirësimin e eficientës, gjatë realizimit të detyrave dhe operacioneve masive në administratën publike. Këto teknologji mund të gjenerojnë kursime në procesin e grumbullimit dhe transmetimit të të dhënave, shpërndarjen e informacionit dhe komunikimin me publikun. Përmirësime të ndjeshme të eficientës konstatohen edhe në rastin e përdorimit të përbashkët të të dhënave brenda sistemit të institucioneve qeverisëse.

- ***E-qeverisja përmirëson shërbimet***

Vendosja e fokusit tek qytetari përbën një element bazë të reformave qeverisëse. Shërbimet e ofruara në mënyrë të suksesshme ndërtohen mbi kuptimin e duhur të nevojave të qytetarëve dhe shërbimet on-line nuk bëjnë përjashtim nga ky parim. Fokusimi tek qytetari do të thotë që përdoruesi nuk duhet ta ketë të nevojshme të kuptojë strukturat dhe marrdhëniet komplekse qeverisëse. Interneti mund të ndihmojë në arritjen e këtij qëllimi, duke i mundësuar qeverisjes të shfaqet si një organizatë e unifikuar dhe të ofrojë në vijueshmëri shërbime on-line. Ashtu si të gjitha shërbimet, edhe ato të e-qeverisjes duhet të zhvillohen duke mbajtur parasysh kërkesën dhe vlerën e përdoruesit, si pjesë e një strategjie të përgjithshme të ofrimit të shërbimeve.

Në vendin tonë, gjatë 5 viteve të fundit janë konkretizuar disa nisma në këtë drejtim. Në vijim janë renditur disa nga më të rëndësishmet:

- ✓ Regjistri Kombëtar civil është dixhitalizuar.
- ✓ Sistemit i Prokurimit Elektronik është zbatuar që nga fundi i vitit 2007 dhe aktualisht të gjitha prokurimet publike realizohen në mënyrë elektronike.
- ✓ Shërbimi i Taksës Elektronike është ofruar në vend që nga viti 2008; Deklarata doganore bëhet në mënyrë elektronike dhe Pasaportat e para biometrike janë lëshuar në fillim të vitit të kaluar.
- ✓ Regjistrimi i bizneseve bëhet me "one-stop-shop", që prej vitit 2007 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe së fundmi për marrjen e licensave në Qendrën Kombëtare të Liçensimit.
- ✓ Po zbatohet një projekt për të ngritur pika aksesit për publikun në të gjitha Zyrat e Postës Shqiptare.

- ***E-qeverisja ndihmon në arritjen e rezultateve dhe pasojave specifike dhe mund të ndihmojë në realizimin e objektivave të gjerë politikë***

Përdorimi i internetit mund t'i ndihmojë grupet e interesit të ndajnë së bashku informacionin dhe idetë, si dhe të kontribuojnë në arritjen e rezultateve specifike të politikave. Psh., informacioni on-line mund të zgjerojë përdorimin e programeve arsimore apo trajnuese; po ashtu ndarja e informacionit ndërmjet qeverisjes qendrore dhe asaj lokale mund të lehtësojë zbatimin e politikave mjedisore. Ndarja e informacionit ndërmjet individëve, megjithatë, ngre shqetësimin lidhur me mbrojtjen e privatësisë, kështu që përfitimet potenciale duhet të vlerësohen me kujdes.

E-qeverisja mund të japë kontribute anësore edhe për realizimin e objektivave të tjerë të politikave ekonomike, duke reduktuar shpenzimet qeveritare nëpërmjet zbatimit të programeve më efektive dhe efçente, duke përmisëruar produktivitetin e bizneseve nëpërmjet thjeshtimit të procedurave administrative dhe promovimit të shoqërisë së informacionit dhe industrisë së TIK.

- ***E-qeverisja mund të japë një kontribut thelbësor për reformat***

Të gjitha qeveritë janë duke u përballur me sfidat e reformimit dhe modernizimit të menaxhimit publik. Zhvillime të tilla si: globalizimi, kërkesat e reja fiskale, ndryshimet shoqërore dhe pritshmëritë në rritje të qytetarëve, sjellin domosdoshmërinë që procesi i reformave të jetë i qëndrueshëm dhe i vazhdueshëm. Janë pikërisht TIK ato që e lehtësojnë dhe mundësojnë këto procese.

- ***E-qeverisja mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes***

Ajo që është e rëndësishme kur flasim rreth Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është mënyra se si këto përdoren nga individët apo institucionet, për përmirësimin në aksesin dhe shpërndarjen e informacionit, me qëllim përfshirjen në dialog, përmirësimin e arsimit, tregtisë dhe të shërbimeve të qeverisë. Ndërtimi i besimit ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes është thelbësor për mirë-qeverisjen. TIK mund të ndihmojnë në ndërtimin e këtij besimi nëpërmjet mundësisë të përfshirjes së qytetarëve në procesin politik, promovimit të qeverisjes së hapur dhe të përgjegjshme, si dhe parandalimit të korrupsionit. Për më tepër, ato mund të ndihmojnë zërat individualë të dëgjohen në debatet e gjera, dhe të adresojnë në mënyrë konstruktive probleme të vërejtura në funksionimin e qeverisjes në të gjitha nivelet.

1.2. Çfarë barrierash pengojnë zhvillimin e e-qeverisjes, përfshirë edhe publikimin on-line të dokumentave zyrtarë?

- ***Barrierat legjislativë dhe rregullatore***

Me qëllim që shërbimet elektronike të gjejnë pranueshmëri të gjerë, ato duhet të konsiderohen si të barazvlefshme me proceset respektive të bazuara në dokumentat e printuara. Për më tepër, kornizat aktuale, të bazuar në supozimin se agjensitë punojnë të vetme, e pengojnë

bashkëpunimin. Gjithashtu, nevoja për privatësi dhe siguri duhet të adresohet në mënyrë serioze përpara se shërbimet on-line të zhvillohen më tej.

Në vendin tonë është bërë një përparim i mirë në procesin e miratimit të legjislacionit të shoqërisë së informacionit, në përputhje me standardet e BE, ku mund të përmendim miratimin e ligjeve:

- “Për Komunikimet Elektronike”;
- “Për Nënshkrimin Elektronik”;
- “Për Dokumentin Elektronik”;
- “Për Tregtinë Elektronike”;
- “Për Mbrojtjen e të Dhënave Elektronike”
- Legjislacioni për krimin kibernetik
- “Për Databazat shtetërore”

- ***Barierat buxhetore***

Në shumë vende, buxhetet e miratuara veprojnë kundër e-qeverisjes efikente duke mos i njohur shpenzimet e TIK si investime. Nevojiten iniciativa për projekte ndër-organizative dhe mjete për matjen e kthimit nga investimet. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një trajtimi të gjerë ndaj vlerësimit të përfitimeve të e-qeverisjes dhe kursimeve të përftuara. Shpenzimet e TIK duhet të njihen si investime, nëse mbajmë parasysh përfitimet e ardhshme dhe garantimin e një shkalle sigurie për financime të ardhshme. Kjo do t’i fokusonte shpenzimet e TIK drejt zhvillimit të zgjidhjeve me efektivitet të kostos.

Për sa i takon vendit tonë është e vërtetë që zhvillimi i shoqërisë së informacionit është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare, prioritet i cili do të vazhdojë të jetë i tillë në iniciativën "Shqipëria dixhitale", që është e përcaktuar qartë në programin e Qeverisë për periudhën 2009-2013.

- ***Përshtatja e zgjidhjeve të e-qeverisjes***

Përballja me sfidat e zhvillimit të e-qeverisjes nuk është e lehtë në kushtet kur ka ende pasiguri në lidhje me ndryshimet teknologjike dhe ndikimet eventuale negative (psh. vulnerabiliteti i sistemeve dhe aktivitetet joligjore). Zhvillimet teknologjike janë duke lëvizur me shpejtësi, gjë që e bën të vështirë parashikimin e detajuar të ndikimeve të ardhshme.

Trajtimet e gjera lidhur me përshtatjen e teknologjive të reja përfshijnë: legjislacion dhe kuadër rregullues neutral nga pikëpamja teknologjike; fleksibilitetin brenda kornizave të gjera rregullatore dhe përshtatjen e ligjeve aktuale me ato të një bote dixhitale; kërkesat e performancës në vend të specifikimeve teknike kur prokurohen teknologji të reja; si dhe bashkëpunim ndërkombëtar në rritje për të harmonizuar çështjet ndër-kufitare.

Ndër zhvillimet në vendin tonë, në këtë drejtim, mund të përmendim:

- ✓ Vitin e kaluar, u miratua nga Qeveria një strategji e re për shoqërinë e informacionit, si dhe ajo për "Shkencën, Teknologjinë, dhe Inovacionin".
- ✓ Janë themeluar prej tre vjetësh Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), dhe së fundmi Agjencia për Kërkim, Teknologji dhe Inovacion (AKTI), si dhe institucioni i Ministrit të Shtetit si përgjegjës për TIK dhe Komunikimet Elektronike dhe Postare.

• *Disproporcionet në zhvillimin dixhital*

Në shumë vende ka ndryshime thelbësore rajonale lidhur me aksesin ndaj TIK dhe internetit. Përgjithësisht, zonat më të disavantazuara kanë nivelin më të ulët të aksesit, ndërkohë që shpesh kanë nivel të lartë marrdhëniesh me qeverisjen. Nëse këto grupe apo individë nuk mund të kenë akses në shërbimet elektronike, ata do të humbisnin mundësinë e përfitimeve nga e-qeverisja. Aksesit i përmirësuar on-line do të rrisë numrin e përdoruesve potencialë dhe do të justifikojë në këtë mënyrë ndërmarrjen e politikave të reduktimit të diferencave në zhvillimin dixhital.

Në funksion të shmangies së këtyre dallimeve vlen të përmendet nisma e Qeverisë: “Shqipëria në moshën e internetit”, në kuadrin e së cilës shkollat publike janë të pajisura në 4 vitet e fundit me laboratorë kompjuterikë, të lidhur me Internet broadband dhe janë hartuar e përshtatur kurrikulat për TIK.

Tregu i komunikimit elektronik në Shqipëri është liberalizuar plotësisht dhe kompanitë që zotëronte shteti dikur janë privatizuar. Penetrimi i telefonisë celulare në këtë vit arriti në 136%, e cila është e krahasueshme me mesataren e BE, ndërsa depërtimi i telefonisë fikse mbetet i ulët. Penetrimi i internetit është rritur gjatë dy viteve të fundit deri në mbi 45%, por depërtimi i broadband është ende i ulët. Zhvillimi i rrjeteve broadband mbetet një nga sfidat kryesore.

Gjithësesi duhet të theksojmë se jo vetëm në Shqipëri por edhe në Ballkan normat e përdorimit të TIK dhe të broadbandit janë krahasimisht më të ulëta se mesatarja e BE dhe se çdo vend po përpiqet të zhvillojë këtë sektor me hapa eksponenciale ashtu siç evoluon edhe kjo teknologji. Vetëm para disa muajsh, Komisioni Federal i Komunikimeve në ShBA propozoi objektiva si 90% penetrim broadband dhe lidhje të banesave me 100 Mbs, duke theksuar se interneti do të zëvendësojë si medium telefoninë dhe televizionin tradicional.

Pra iniciativa "Shqipëria dixhitale" nuk ka në thelb të saj përdorimin e kompjuterit, sistemet e bazave të të dhënave në internet dhe faqet web - edhe pse të gjitha këto janë të rëndësishme. Por ka të bëjë me përdorimin e tyre për të nxitur qeverisje efektive dhe politika demokratike, të gjithëpërfshirjes. Dhe sidomos ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve krejt të reja edhe për imagjinatën e sotme. Qëllimi është pajisja e çdo nxënësi me kompjuter dhe çdo kompjuter i lidhur me internet në mënyrë që edhe banori i fundit i krahinës më të largët, po të dojë, përmes celularit të tij, do të mund të paguajë faturat e dritave, ujit apo telefonit.

2. Praktikrat e disa vendeve europiane dhe rasti i Shqipërisë

Gazetat qeveritare, të cilat publikohen nga qeveritë në mbarë botën, janë mjetet me anë të të cilave qeveria mund të komunikojë me zyrtarët dhe me publikun e gjerë. Megjithëse shumë vende publikojnë gazeta qeveritare, rregullat dhe përmbajtja e tyre variojnë gjerësisht, gjë e cila vihet re në përshkrimin e çdo gazete. Gazetat nuk janë të nevojshme thjesht për të monitoruar veprimet e qeverisë por shërbejnë edhe si burime kryesore dokumentacioni për kërkime.

Në kuadrin e globalizimit dhe përafrimit të legjislacionit të vendeve të Europës me njëri tjetrin aksesimi në Ditar/Gazeta/Fletoret Zyrtare (më poshtë po i referohemi si fletoret zyrtare) të këtyre vendeve është shumë i rëndësishëm. Për këtë arsye në vitin 2004 u krijua Forumi European i Fletoreve Zyrtare me mandat për të nxitur bashkëpunimin midis fletoreve zyrtare të Vendeve Antare dhe Vendeve Kandidate për në Bashkimin European. Që nga viti 2005, Forumi është i hapur për t'u vëzhguar edhe nga vendet e tjera Europiane.

Disa nga objektivat e këtij Forumi European janë:

- o Publikim në mënyrë më eficiente dhe më automatike i legjislacionit dhe njoftimeve të tjera zyrtare
- o Publikim më i saktë dhe ligjërishit i vlefshëm
- o Publikim sa më jetëgjatë
- o Një fletore zyrtare më user-friendly dhe më atraktive për përdoruesit

Gjithashtu Forumi nxit punën për përmirësimin e faqeve të Internetit që lidhen me fletoret zyrtare për t'i dhënë më shumë prioritet përdorimit sa më eficient dhe në mënyrë ergonomike të mjeteve të kërkimit, si dhe ofrimit të legjislacionit të konsoliduar në të gjitha gjuhët zyrtare duke përfshirë edhe ndryshimet e mëvonshme.

Forumit realizon një takim të përvitshëm dhe pikërisht në takimin e realizuar vjet në 10-11 Shtator 2009 në Londër u diskutuan tendencat më të fundit dhe ato të ardhshme që lidhen me publikimin e fletoreve zyrtare. Tendenca aktuale në BE synon në përmirësimin e lidhjes ndërmjet EUR-Lex (website i cili ofron akses pa pagesë në ligjet dhe dokumentat e tjera të BE-së) dhe databazave të veçanta legjislative të Vendeve Antare. Kjo nyje informacioni do t'i mundësojë përdoruesve aksesin në aktet ligjore për një çështje të caktuar në të gjitha vendet e BE, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavaruar nga burimi i këtyre akteve.

Kërkesat më të fundit që lidhen me publikimin e fletoreve zyrtare janë:

- o Eficiencë – inputet të jenë të parashikuara dhe të standartizuara
- o Cilësi – korrektësi
- o Produktivitet – nxjerrjen e outputeve nga inputet
- o Fleksibilitet – në fund të vitit gjithmonë ka një bum legjislativ, vështirësi për të parashikuar tendencat
- o Shumëformatshe – përdoruesit duan dokumenta në formate të ndryshme
- o Autenticitet – burim i verifikueshëm
- o Ruajtje për një kohë të gjatë – ligjet të jenë në dispozicion edhe në 2110?
- o Modele të reja të financimit të rezistave zyrtare

Përdorimi i gazetave zyrtare elektronike është rritur me shpejtësi. Në të njëjtën kohë numri i kopjeve të printuara dhe numri i abonentëve janë ulur. Për këtë arsye printimi i kopjeve në letër sa vjen e bëhet më pak eficient në drejtim të kostos.

Figura 2.1 Zhvendosja nga printimi drejt faqeve web



Shitjet në versionin letër



Përdorimi online

Në këndvështrimin retrospektiv, mund të identifikohen disa momente me rëndësi të veçantë në shtete të caktuara që lidhen me zhvillimin e fletoreve zyrtare elektronike.

o Estonia:

23.01.2001 versionet elektronike dhe ai në letër janë të njëvlershëm. Që nga 01.01.2007 versioni elektronik është i vetmi version autentik.

o Belgjika:

01.01.2003 versioni elektronik nuk është autentik por është i vetmi version gjerësisht në përdorim (vetëm 5 kopje të printuara janë autentike). Përveç kësaj një helpdesk me akses të lirë i përshkruar në ligj dhe një përmbledhje e fletores zyrtare disponohet në çdo gjykatë.

o Austria:

01.01.2004 është në përdorim vetëm versioni elektronik i cili është autentik. Përveç kësaj janë në përdorim versione elektronike jo autentike (html/pdf) si dhe 5 kopje të printuara për arshivim

o Francë:

01.07.2004 versioni elektronik dhe ai i printuar janë në mënyrë të barabartë autentike

o Hungari:

01.01.2006 versioni elektronik i gazetës legale bëhet autentike

o Portugali:

01.07.2006 versioni elektronik bëhet fletore zyrtare autentike. Aktet bëhen zyrtare vetëm pasi janë publikuar në fletoren elektronike në www.dre.pt. Versioni në letër i fletores zyrtare nuk është printuar më pas 31.12.2006

o Sllovenia:

01.01.2007 versioni elektronik dhe ai i printuar janë në mënyrë të barabartë autentike, në rast konflikti version elektronik ka përparësi.

o Danimarka:

01.01.2008 versioni elektronik është i vetmi version autentik.

Versioni elektronik zyrtar është një version i ligjit i publikuar në formë elektronike dhe i njohur nga autoritetet kombëtare si një dokument elektronik zyrtar. Versioni elektronik zyrtar mund të ketë status të ngjashëm si versioni në letër i ligjit. Statusi i versionit elektronik mund të bazohet në një akt specifik, procedurë administrative ose ndonjë autorizim tjetër. Versioni elektronik zyrtar mund të jetë i barabartë me versionin në letër të fletoreve zyrtare (si në disa vende të përmendura më lart) ose mund të jetë i vetmi version zyrtar.

Nga shqyrtimi i rasteve konkrete të vendeve më të përparuara në këtë drejtim shtysat për të realizuar automatizimin ishin të ndryshme në secilin vend. Psh. në Danimarkë, për shkak të periudhës gati 100 vjeçare të botimit të gazeatve zyrtare, numri i akteve ligjore ishte bërë shumë i madh dhe nuk kishte asnjë mënyrë eficiente për të identifikuar se cilat akte ligjore ishin akoma në fuqi. Ishte shumë e vështirë për të gjetur ligjet dhe rregullat që mbulonin një çështje të caktuar. Pra nevoja për të gjetur në mënyrë eficiente ligjet aktuale në fuqi shërbeu si forca lëvizëse drejt automatizimit. Në Norvegji, databaza e parë ligjore u ngrit nga nevoja për krijimin e një formati të ri të paraqitjes së akteve ligjore. Përpunimi i të dhënave ligjore u zhvillua në Suedi, si një mjet për të shkëmbyer këtë informacion në mënyrë efikase midis departamenteve të ndryshme të qeverisë. Pavarësisht nga arsyet e ndryshme të secilit vend, qeveria luajti një rol të madh në krijimin e bazave të të dhënave ligjore. Qeveria daneze filloi si sistemin kryesor ligjor, “Retsinformation”, ashtu edhe website-in “Folketing”. Qeveria norvegjeze ndikoi në zhvillimin e sistemit “Lovdata”, edhe pse ja delegoi menaxhimin e këtij sistemi një organizatë private. Në të tre këto vende, databazat ligjore më të hershme përmbanin kryesisht ligjet dhe rregulloret. Më vonë, ato u zgjeruan dhe përfshinë publikimet ministrore dhe dokumentat parlamentare.

Shqipëria (vend potencial për kandidat në BE)

Fletorja e vetme zyrtare që publikohet në Shqipëri është Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë e cila publikohet nga Qendra e Publikimeve Zyrtare (QPZ). QPZ ka për qëllim publikimin e akteve ligjore e nënligjore të shtetit shqiptar. Numri i Fletoreve Zyrtare është dyfishuar dhe trefishuar çdo vit. Kjo për shkak të shtimit të akteve të shtetit shqiptar, rritjes së

shpejtësisë së botimit, si dhe rritjes së volumit për shkak të botimit edhe të teksteve të marrëveshjeve të ratifikuara me ligj, të cilat nuk botoheshin më parë.

Kopja e pare e kësaj Fletoreje është publikuar në 14 Dhjetor 1999 ndërsa publikimi i pare online është realizuar në Dhjetor 2004. Faqet zyrtare janë ***www.legjislacionishqiptar.gov.al*** dhe ***www.qpz.gov.al*** si dhe mund të kontaktohet nëpërmjet numrave të telefonit Tel: +355 425 84 72, Fax: +355 423 29 65 si dhe me e-mail: ***info@qpz.gov.al***

Kopja e printuar kushton 14.000 lek (120 euro) nëqoftëse merret pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare dhe 16.000 lek (138 euro) nëpërmjet abonimit postar. Ndërkohë që informacioni ofrohet edhe në CD që nga 25 Qershor 2005 me një çmim 3.000 lek (25 euro) në vit për një set të Fletores Zyrtare. Fletorja Zyrtare financohet nga buxheti i shtetit ndërsa versioni online ofrohet falas.

Informacioni që publikohet në Fletoren Zyrtare përfshin ligjet, dekretet, vendimet e Parlamentit, vendimet, rregulloret dhe urdhëresat e Qeverisë, Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Pasurisë, Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese, liçensat, vendimet dhe udhëzimet e Bankës Qëndrore dhe udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe Entit Rregullator të Energjisë. Zakonisht përmbajtja e Fletores Zyrtare përfshin ligjet në një botim dhe vendimet në një tjetër. Baza ligjore për publikimin e legjislacionit është Kushtetuta e Shqipërisë, së bashku me ligjin nr. 8502 dt. 30 Qershor 1999, ndryshuar me ligjin nr. 9091 dt. 29 Qershor 2003: “Mbi krijimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare”.

3. Përfitimet dhe sfidat e kalimit nga botimi i printuar në versionin online të Fletores Zyrtare

Është e qartë se kur shqyrtohet kjo çështje duhet marrë në konsideratë pasojat që do të sjellë publikimi në web i Fletores Zyrtare. Padiskutim ky kalim do të çojë në një reduktim të konsiderueshëm të numrit të abonentëve në versionin në letër dhe në të njëjtë kohë kërkon të kryhet një investim i konsiderueshëm për të adoptuar teknologji të reja të cilat po bëhen gjithnjë e më tepër dominuese.

Që të jetë i sukseshëm një ndryshim i tillë kërkohen:

- o Ndryshime të shpejta në modelin e funksionimit të sistemit të publikimeve
- o Ndryshime të shpejta në ambjentin teknologjik

- o Ndryshime në mënyrën e të menduarit të përdoruesve (qytetarë, biznese dhe nënpunës shtetëror)
- o Kërkesa për shërbime më fleksible dhe me cilësi më të lartë

Fletore Zyrtare - vetëm elektronike?

Kalimi i Fletores Zyrtare në versionin tërësisht online duket si një rrjedhim llogjik i disa zhvillimeve korrente që favorizojnë këtë kalim:

1. Kostoja në rritje e publikimit të Fletores Zyrtare dhe numri në rënie i abonentëve
2. Metoda të reja janë shfaqur për garantimin e autencitetit të Fletores Zyrtare (nënshkrimi elektronik, çertifikata elektronike etj)
3. Mundësia për të përshpejtuar procesin e publikimit
4. Lehtësi në arshivimin dhe aksesin e të dhënave historike
5. Politika mbështetëse e Qeverisë ku mund të përmendim iniciativën "Shqipëria dixhitale"

Përfitimet e këtij procesi mund të grupohen në dy kategori kryesore:

1. Përfitime për qytetarët, bizneset dhe shoqërinë:
 - o Akses më i shpejtë dhe më eficient në informacionin e nevojshëm ligjor
 - o Kursim i kohës për sigurimin e informacionit të vlefshëm
 - o Rritje e cilësisë së aktiviteteve individuale apo të biznesit
 - o Ulje e kostos së kryerjes së këtyre aktiviteteve (psh. në Portugali është vlerësuar që kursimet vjetore shkojnë deri në 200 million euro në kostot direkte të kryera nga qytetarët dhe kompanitë)
 - o Redukton shkeljet e pandërgjegjshme të ligjit
 - o Nxitje e përdorimit të internetit duke stimuluar kështu përdorimin masiv të TIK
2. Përfitime për administratën dhe qeverinë:
 - o Do të përafrojë standartet tona qeverisëse me ato europiane
 - o Ulje të kostos së printimit të versioneve në letër
 - o Komunikim më i mirë brenda administratës publike
 - o Kursim i kohës në ofrimin e shërbimeve
 - o Shpejtim procedurash administrative

- o Do të rrisë imazhin (prestigjin) ndërkombëtar në sytë e investitorëve të dhe partnerëve të huaj

Sfidat që lidhen me Fletoret Zyrtare:

- o *Sfida e skemës së financimit*: shtrohet pyetja nëse ky sistem i ri publikimi i fletores zyrtare do të financohet vetëm nga Buxheti i Shtetit apo do të jetë i hapur edhe për bashkëpunime me subjekte private
- o *Zhvillimi i burimeve të reja të të ardhurave*: konsiston në ofrimin e shërbimeve online me vlerë të shtuar brenda kornizës së “Fletores Zyrtare” si psh ofrimin e versioneve të reja të printimeve për një grup të caktuar ligjesh, shërbime sipas kërkesave, shërbime të personalizuar (psh. dërgimi i ligjeve mbi pasuritë e patundshme dhe tatimet), njoftim për aktet dhe ndryshimet më të fundit, vendosja e reklamave apo njoftimeve me pagesë etj.
- o *Konsolidimi i akteve ligjore*: kjo sidomos në rastet e ndryshimeve të shpeshta të akteve ligjore duke i ofruar përdoruesit një version lehtësisht të lexueshëm

4. Rekomandime

Qëllimi i procesit të kalimit të Fletores Zyrtare tërësisht online nuk është thjesht vendosja e legjislacionit në web por që ai ti vijë në ndihmë maksimalisht përdoruesit.

Egziston një portal www.e-albania.al e cila ofron informacion të kategorizuar në tre grupe: Informacion për Qytetarët, Bizneset dhe Qeverinë. Për secilin prej kategorive nëpërmjet lidhjeve (link) të ndryshme një përdorues çfarëdo mund të hapë faqen e një ministrie apo të një institucioni varësie.

Duke u nisur nga eksperiencat më të mira të vendeve të zhvilluara rekomandojmë krijimin e një portali të ngjashëm, që mund të jetë psh. www.qpz.al, i cili të bëhet nyja qendrore e aksesimit për legjislacionin shqiptar e më gjerë, pse jo edhe e informacionit që lidhet me rregullat apo vendimet e miratuara nga Bashkitë apo Komunat. Pra në këtë portal të mos jenë të listuar vetëm fletoret zyrtare por të jetë i organizuar në një formë të tillë ku përdoruesi lehtësisht mund të gjejë atë ligj apo akt ligjor që atij i intereson. Pra qëllimi është sigurimi i aksesit për përdoruesit në të gjitha tekstet zyrtare dhe dokumentat paraprake, por edhe në dokumenta të tjerë

të cilët mund të ndihmojnë përdoruesit në procesin e marrjes së vendimeve apo kontekstin e akteve që miratohen.

Pra nuk bëhet fjalë thjesht për të mbledhur të gjithë dokumentacionin në të njëjtin vend, por për të siguruar akses në vendet ku të dhënat janë ruajtur, për të siguruar mjetet që i lejojnë përdoruesit të kuptojnë përmbajtjen e tyre. Website duhet të jetë i orientuar drejt qytetarit: tekstet ligjore janë të vështira për t'u kuptuar, kështu që përdoruesit kanë nevojë për përmbledhje të legjislacionit, përshkrime, deklarata shtypi, shënime për shpjegime, pra mjete për ta bërë ligjin më të aksesueshëm.

Për të krijuar një portal të tillë mund të ishte e arsyeshme të ndërmerrej një projekt qeveritar i cili të përfshijë një numër të madh dhe me shtrirje të gjerë njësisish qeverisëse, duke u orientuar nga një qëllim i vetëm: **ligje më të thjeshta, më të qarta dhe lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët dhe bizneset.**